


Apostuli i distriktit Ehlebracht: I dashur apostuli ynë kryesor. Më lejo që të flas për një moment përpara bashkësisë së re të Shqipërisë. Që kur u përcaktua data që do të vinit në Shqipëri personalisht, zemrat tona patën një gëzim të madh. Dhe ky gëzim u rrit vazhdimisht deri sot që e përjetuam. Ne e dinim që kishim një apostul kryesor i cili banonte në Zyrih. Por sot patëm mundësinë për të njohur dashurinë tuaj, punën tuaj dhe ju vetë personalisht. Dhe kjo na i ka prekur të gjithëve zemrat. Ne e përjetuam këtë ditë të madhe festive, dhe u bindëm se sa e madhe është mëshira dhe zemërgjerësia e Zotit. Ai nuk ka hyrë në jetën tonë dhe nuk na ka ndihmuar vetëm ne, porse mëshira e tij është për të gjithë ata shpirta që e kërkojnë atë. Dhe ne e pamë vetë se shënjtërimet e kishës u dhanë për të gjithë ata që erdhën pranë altarit të perëndisë. Me përshtypje të thella në shpirtin tonë, kthehemi ne nëpër shtëpia dhe këshillën tënde e kemi kuptuar shumë mirë se duhet të qëndrojmë besnikë e ta ndjekim këtë kishë, e të shikojmë gjithnjë lart me gëzim deri në ditën e Zotnisë. Ne të urojmë ty dhe shoqëruesve të tu tani, rrugë të mbarë dhe gëzohemi kur të takohemi edhe një herë me ju. Dhe ju premtojmë se kjo sallë do të jetë e mbushur deri në vendin më të fundit. Ju faleminderit shumë, apostul kryesor.



Apostuli kryesor: Mendoj se korri mund të këndojë edhe një herë dhe gjatë këngës ne do të largohemi prej këtu. Zini vend edhe për pak kohë. Mirupafshim.

Të rejtat e Kishës Apostolike të Re



No. 1/95



Shqipëria është një nga vendet më të panjohura të Europës. Kush dëshëronte të dinte për këtë vend, duhej të kërkonte gjatë deri sa të gjente dicka sepse me vite të tëra kanë jetuar shqipëtarët pothuajse të mbyllur hermetikisht nga bota. E kishin për krenari që ishin vendi i vetëm ateist në botë. Veprimtaria fetare që e ndaluar dhe dënohej. Ishte ndër vendet më të varfëra të kontinentit europian dhe ka vetëm katër vjet që ndryshoi regjimin. E kush nuk i kujton pamjet kur mijëra shqipëtarë të hypur në anijet e portit të Durrësit u larguan për në Itali. Pikërisht në ato kohë u bë e mundur që puna e Zotit të fillonte edhe në këtë vend, në tokën e Shqipëtarëve, sic e quajnë ata veten e tyre. Tani mbas katër vjetëve e vizitoi për herë të parë Apostuli kryesor këtë tufëz të re të fëmijëve të Zotit e cila iu la për kujdesje distriktit të Vestfalisë së Rinit verior që nga viti 1990.

APOSTULI KRYESOR VIZITOI FEMIJET E ZOTIT NE TOKEN E SHQIPETAREVE


Kush udhëton sot nëpër Shqipëri do të kujtojë pak a shumë pasazhe nga libri i Karl May-it "Nëpër tokën e Shqipëtarëve". Në shumë aspekte të jetës së përditëshme duket sikur koha ka mbetur në vend dhe nuk ka shenja të ndonjë përmirësimi të dukshëm. Fshatarët e punojnë tokën me vegla si të shekullit të kaluar dhe për traktorë modernë as që mund të bëhet fjalë. E vetmja pronë e një familje fshatare janë një tufëz bagëtie. Megjithatë shqipëtarët janë një popull shumë mikëpritës, veti kjo që e bëri të mundur fillimin e punës së Zotit edhe në këtë vend. Kur apostul Bernd Klippert do të ndërmerre udhëtimin e tij të parë në këtë vend misionar më 1991, iu desh të kapërcente shumë pengesa. Për të hyrë një europiano-perëndimor në Shqipëri, i duhej një fletë garanci apo një ftesë e një qytetari shqiptar. Për këtë u tregua i gatshëm i ati i një azilanti politik shqiptar me banim në Vestfali. Duke mos i pasur kushtet për të pritur dy të huaj, e merr përsipër vëllai i tij Agim Nikshiqi për ta cuar deri në fund këtë ftesë të bërë apo këtë karakteristikë të shqiptarëve, mikpritjen. Si ditë takimi u caktua data 24 shtator 1991.

"Ndërsa udhëtoja për në aeroport, në mendjen time unë prisja dy njerëz me xhybe të gjata të zeza dhe me mjekër të gjatë." Kështu shkruante në kujtimet e saj e bija. Megjithëse ishte 37 vjece, ajo nuk dinte asgjë rreth besimit kristian. Kështu hapi familja Nikshiqi zemrën për fjalën e apostulit.



Gjithcka që nuk kuptonin në fillim u kthye në njohuri pak më vonë. Pesë ditë më vonë më 29 shtator 1991 u mbajt në kryeqytet, në Tiranë, shërbesa e parë fetare nga apostuli. Shpirtrat e parë ndër të cilët bënte pjesë dhe e bija, morën vulën e shenjtë. Po në të njëjtën ditë u emërua në detyrën e nën/diakonit edhe i ati i saj. Në total, deri në largimin e Apostulit, morën ujin dhe vulën e shenjtë 21 shpirtra. Hapi më i rëndësishëm ishte regjistrimi i plotë i Kishës Apostolike të Re në Shqipëri. Fillimi që i mbarë.

Deri në fund të shtatorit të vitit të kaluar, numri i fëmijëve të Zotit u rrit deri në 1500 vetë. Në 11 qytete u krijuan bashkësitë të cilat merrnin pjesë në shërbesat fetare. Për këta shpirtra që një gëzim i vecantë që pritën në fillim të nëntorit të kaluar, Apostulin kryesor.



Kur ky shërbëtor i parë i Zotit arriti në Tiranë, termometri shënonte 22 gradë celcius, gjë që kushtëzohet nga shtrirja gjeografike e këtij vendi. Për të përshëndetur ardhjen e Apostulit kryesor kishin ardhur në Rinas rreth 40 vëllezër të administratës (shqiptarë) si dhe vëllezër të Vestfalisë së Rinit verior që kryejnë shërbimin në këtë vend. Në këtë vizi-të të parë të tijën, Apostuli kryesor kishte ftuar apostulin e distriktit (ndihmës) Xhon W. Fendt (USA), apostul Vasil Cone (Rumani) si dhe apostul Rudolf Kainz (Austria). Me apostulin e distriktit Horst Ehlebracht erdhën edhe apostujt Dewan Chowdhury, Bernd Klippert, Klaus Dieter König, Hermann Magney si dhe apostul Alfred Kusserow, tashmë në pension. Se çfarë ndjente në shpirt apostuli kryesor në këtë vizitë të parë të tijën, e shprehin qartë fjalët që ai tha në mbyllje të ditëve në Shqipëri: "Në Shqipëri është derdhur shumë gjak si rezultat i pushtimeve të shpeshta. Le të na dhurojë ne Zoti një festë të zemërgjerësisë, mëshirës e clirimi të shpirtrave tanë."

Historia e këtij vendi dhe e këtij populli fillon me historinë e Ilirëve dhe të mbretërisë së tyre. Rreth viteve 1000 para Krishtit, zbritën ata nga europa qendrore dhe u vendosën në pjesën perëndimore të gadishullit të Ballkanit. Në fund të shekullit të tretë dhe në fillim të shekullit të dytë. p. Kr. pushtohet dhe zaptohet krejtësisht nga Romakët. Në vitin 395 Arbëria, sic e quajtën ilirët, u bë pjesë e perandorisë bizantine. Fise sllave erdhën dhe zunë vend në mes të shekullit të gjashtë, mbas Krishtit gjë që solli dhe fundin e sundimit bizantin. Ndarja e kishës ortodokse me 1054 nga kisha romake la gjurmë edhe mbi Shqipërinë. Po kështu ndjeu ky vend edhe kalimin e kryqëzatave të para.

Po kështu mbeti Shqipëria edhe në shekujt e mëpastajme, një vend jo i qetë, një popull me historira të ndryshme. Ajo është e lidhur ngushtë me emrin e Gjergj Kastriotit apo Skënderbeut i cili lindi si bir i princit të Krujës më 1405. Që i vogël Gjergj Kastrioti u rrëmbye nga Turqit të cilët sundonin në atë kohë, dërgohet në Turqi ku i ndërrohet edhe feja e bëhet mysliman. Më 1440 kthehet ai përsëri në vendlindjen e tij dhe në besimin kristian. Me 1444 mbledh ai në Lezhë të gjithë princat e Shqipërisë në një

kuvend që njihet me emrin “Besëlidhja e Lezhës” e ku vendoset në plan të parë lufta kundër turqve. Kur ushtria osmane me rreth 60.000 ushtarë sulmoi më 1457 Shënderbeun dhe ushtrinë e tij, pushtuan ata një pjesë të madhe të zonave të thella, ndërsa kështjellën e Krujës ku ishte tërhequr vetë Shënderbeu, nuk mundën ta merrnin. Sot në atë vend dëshmon edhe një muze për veprat, bëmat e atyre ditëve.

Nje lidhje e ngushtë krijohet në ato kohë edhe me Italinë. Kështu në shekujt 15/16 shpërngulen për në Itali prej urisë dhe pushtimit sulltan, me qindra e mijëra shqiptarë. Ndërsa më 1921 konferenca e ambasadorëve njohu pavarësinë e Shqipërisë u respektuan aty edhe interesa të vecanta të Italisë.

Më 1967 ndalohen kategorikisht të gjitha aktivitetet fetare nga regjimi në fuqi. U mbyllën e u rrënuan të gjitha kishat, xhamitë apo institucionet fetare. Vetëm më 1991 u legalizua e u lejua ushtrimi i feve dhe klerikët u lejuan të punonin përsëri. “Shqipëtarët janë me të vërtetë një nga popujt më të vjetër dhe me histori të lashtë sa nuk dihet me saktësi” thotë gjatë vizitës së tij apostuli kryesor. Ka mundësi që edhe apostul Pauli, gjatë udhëtimit të tij për në Romë, të ketë kaluar nëpër këtë zonë. Dhe në një letër drejtuar Romakëve thoshte ai ndër të tjera: “Njerëzit nga të gjithë popujt iu nenshtruan Perëndisë duke dëgjuar lajmin e mirë. Por unë nuk e mbaj këtë për arritjen time, sepse këtë Mesia e ka arritur me anë të fjalës dhe të veprimtarisë time, me anë të mrekullive të mëdha, në të cilat Perëndia tregoi fuqinë e tij. Prandaj lajmin e mirë për Mesinë arrita ta sjell gjithkund, nga Jerusalemi deri në Iliri.”



Si gjithnjë, përpara një shërbese fetare për shpirtrat e vdekur, me anë të një lutjeje të vecantë dhe në një orë të shkurtër festive, hap apostuli kryesor të gjitha dyert e botës së përtejme që shpirtra të shumtë të zbresin tek altari, te shenjtërimet dhe tek apostujt e kishës së Krishtit. Për këtë qëllim mblidhen në një sallë të vogël të pallatit të

kongreseve, rreth 100 motra e vëllezër të bashkësisë të Tiranës. Një korr që përbëhet më shumë nga të rinj dhe një orkestër e vogël e rrethuan, e mbushën këtë orë të qetë në mes të së cilës qe fjala e apostulit kryesor e marrë nga 1 Korintasit 15, 29.

Mëngjesin tjetër erdhën në pallatin e kongreseve motra e vëllezër nga të gjitha 11 bashkësitë për të marrë pjesë në shërbesën fetare për shpirtrat e vdekur. Për të gjithë është një përjetim i vecantë. Për herë të parë e shikojnë dhe e dëgjojnë ata apostulin


kryesor. Për herë të parë patën ata mundësinë që të përjetojnë në një grup kaq të madh, gëzimin e vecante që pas shërbesës, 35 shpirtra të bashkësisë më në jug, Korcës, të merrnin nga vetë dora e apostulit König, vulën e shenjtë. Me këta shpirtra të rinj shkon deri në 80 numri i femijëve të Zotit brenda një kohe relativisht të shkurtër që nga Maji i vitit 1994.

Për shërbesën fetare apostuli kryesor zgjedh rreshtin 11 të psalmit 88, i cili thotë: “A do të bësh ti ende mrekulli tek të vdekurit?” Gjatë fjalës së tij, apostuli kryesor i kthehet historisë së popullit tonë dhe e quan atë nga vendet e “harruara” të Europës. “Pjesën



më të madhe të kohës vendi juaj ka qenë i pushtuar nga fuqi të huaja. Ata shkonin e vinin. Dhe kjo ju kushtonte gjak e lot. Të shumtë ishin ata që shkuan në atë jetë të mbushur me urrejtje ndaj armikut, pra pa e falur atë. Porse Jezusi nuk na mëson kështu. Në fillim pajtimi e mëpastaj edhe ta falësh armikun, vetëm kështu mund të marrë shpirti yt mëshirë e forcë nga sakrifica e Jezusë e të clirohet. Kështu sqaroi e dha apostuli kryesor kuptimin e qëllimin e kësaj shërbese fetare të vecantë.

Dëshëroj që kjo ditë të jetë për punën e Zotit në Shqipëri, një hap më përpara në pajtimin dhe clirimin e shumë shpirtrave të asaj bote, jete, që kanë jetuar në kohën e sundimeve të para. Uroj që ju të forcoheni nga fjala e Zotit e nga mëshira e tij dhe nëpërmjet asaj që ju do të rrezatoni të mblidhni rreth vetes shumë e shumë shpirtra të tjerë” Këto fjalë tha apostuli kryesor në mbyllje të shërbesës.



RAPORT

mbi shërbesën fetare të mbajtur nga Apostuli kryesor më 6/11/1994, në Tiranë/Shiqipëri.

Kënga e fillimit: "Një mesazh ka plot mëshirë"-shqip-(LK 593)

Lutja: Në emër të Atit, Birit dhe Shpirtit të Shenjtë!

O Zot i madhërishtëm e i perjetshëm që je në qiell! I miri e i dashuri Ati ynë! Me një ndjenjë të thellë respekti dhe mirënjohjeje vijmë tek ti. Ishe ti ai që na drejtove të gjithëve përpara altarit tënd. Është përsëri e dielë dhe ne na jepet mundësia për të ardhë tek ti me gjithcka që ndiejmë brenda nesh. Së pari merr mirënjohjen tonë, o At, për ndihmën dhe mëshirën e dhënë. Tani na i dëgjo të gjitha lutjet dhe shqetësimet. Gjithcka që na shqetëson dhe pyetjet që kemi, pergjigju ti, o At. Ndryshouja kushtet, jepu forcë për t' i përballuar dhe pergjigju të gjitha pyetjeve të zemrës. Tani na shërbe ne me fjalën tënde sepse kjo fjalë është për të gjithë ne. Ajo nuk është vetëm një fjalë e thjeshtë por ashtu sic thoshte edhe vetë Jezusi për fjalët e tij: Në to ka shpirt, ka jetë. Na dhuro tani të gjithëve mëshirën tënde sepse vetëm nëpërmjet kësaj mëshire do të clirohemi ne dhe do të qëndrojmë të drejtë përpara teje. Na lumtëro ne në këtë bashkësi të fëmijëve të Zotit. Kushdo që hedh sytë rrotull dhe shikon këta mijra shpirtra këtu dhe mendon apo ndjehet i vetmuar ndonjë ditë, duhet të thotë: Jo, unë nuk



jam vetëm, unë e pashë vetë, unë kam shumë motra e vëllezër të besimit. Sot kemi edhe miq, vizitorë nga përjetësia. Të gjithë ata që e kanë dëshirën në zemër për të marrë ndihmën, mëshirën e tij dhe të gjithë ata që kanë zbritur, janë tashmë rreth altarit. Ne nuk i shohim se ata nuk kanë më veshje tokësore porse

shpirti ynë ndjen shumë më tepër sesa shohim me sy. Na jep më shumë se sa të kërkojmë, i dashur At dhe bekoje popullin tënd në të gjithë botën. E të gjitha këto na i dëgjo në emër të Jezusë. AMEN

Apostuli kryesor: Të dashur motra e vëllezër. Për sot në këtë ditë të vecantë po lexoj unë një fjalë të marrë nga Psalmi 88. Do të dëgjoni fjalinë e parë të rreshtit 11: “A bën ti ende mrekulli tek të vdekurit, ...?”

Korri: “Zemrën tënde jepma mua...” - shqip -

Apostuli kryesor: Të dashurit e mi, motra e vëllezër të besimit! Me gëzim të madh kam ardhur unë tek ju. Gëzohem sepse edhe në Shqipëri kam kaq shumë motra e vëllezër të një besimi. Përpara tre vjetësh nuk kishte marrë vulën e shenjtë askush këtu. Ndërsa sot më se një mijë shpirtra janë mbledhur rreth altarit. Me të vërtetë Zoti ynë i dashur me dashurinë e tij mbledhi shumë nga ju në këtë rrugë kaq të mrekullueshme. Ai ju dhuroi mëshirë që të njihnit punën e tij. Që nga dita kur morët vulën e shenjtë u quajtët ju fëmijë e më të madhërishmit. Me kënaqësi erdha unë në Shqipëri, në këtë vend të vogël por me një histori të vecantë e prekëse. Unë u mora pak me historinë e vendit tuaj dhe për këtë pashë dicka: Kohën më të madhe të historisë suaj e zenë pushtimet e të huajve. Qindra vjet vetëm nën pushtimin turk. Popuj të ndryshëm kanë hyrë e kanë dalë. Dhe vetëm lot e gjak i ka kushtuar këtij populli. Të shumtë janë ata që kanë shkuar në përjetësi me mendimin dhe ndjenjën në zemër për të mos i falur armiqtë e tyre. Por kështu nuk na mësojnë mësimet e Jezu Krishtit. Sot është një ditë e vecantë në të cilën ne mendojmë për të gjithë ata që janë në përjetësi, për të gjithë



jepet ndihma e Zotit nëpërmjet altarit. Dhe altari është i ngritur këtu, në toke- ai nuk është në qiell- prandaj të gjithë duhet të vijnë këtu. Por ama këto shpirtra duhet ta dinë: Vetëm me një shpirt të butë, të pajtueshëm arrin njeriu të clirohët. Dhe vetëm pasi të jetë i cliruar krejtësisht, mund të jetë ai i gëzuar. Në fillim të falë, qoftë edhe armiqtë e tij, pastaj vjen clirimi që u bë i mundur nga sakrifica e Krishtit. Kush e ndjen clirimin e shpirtit të tij, ka mundësinë për të qenë i gëzuar e i lumtur. A mund të mendojnë pastaj edhe për të vdekurit? Unë mendoj se të gjithë e bëjnë këtë. Dikush zbukuron varrin, dikush merr një fotografi të vjetër në dorë dhe shikon gjyshen apo stërgjyshin e tij. Pastaj kujton njeriu të njohurit e tij që ndërkohë kanë vdekur. Pa dëgjon njeriu në shkollë në lëndën e historisë për figura të shquara. Pra njeriu mund të kujtojë të këtushmit e të përtejmit. Por ama njeriu nuk mund të njohë me emër të gjithë ata që

tashmë janë në përjetësi. Prandaj është në të gjitha fetë kështu, që në një ditë të caktuar të lutet për të vdekurit. Krejtësisht ndryshe është në punën e Zotit. Tek ne kanë mundësi që të ndihmohen këta shpirtra. Këngëtari i psalmeve thoshte këtu në tekstin që u lexova: “A do të bësh ti mrekulli edhe midis të vdekurve?!” Atëherë qe e mundur kjo: Armiqtë dhe kërkuesit e Davidit e ndiqnin atë e perpiqeshin për ta vrrarë. Asnjë ditë nuk ishte ai i sigurt nëse do të jetonte apo jo. Kur mendonte, ja vlente më mirë të vdiste. Me këtë shqetësim në zemër ju kthye ai Zotit dhe e pyeti: “A do të bësh ti edhe midis të vdekurve mrekullira?” Me këtë donte të thoshte: “Bëj më mirë tek të gjallët dhe më nxirr mua nga ky hall.” Ne e dimë që atëherë në kohën e Davidit dhe më vonë, nuk mund të bëhej shumë për të vdekurit. Për këtë gjë flet edhe shembulli i pasanikut që kishte rënë në hall. Unë nuk mund ta tregoj në detaje këtë shembull tani, pasi do të më ishte dashur shumë kohë. Porse nga kjo ndodhi e asaj kohe ne nxjerrim, kuptojmë se qe një ndarje në përjetësi prandaj nuk mund të cliroheshin shpirtrat e të tjerëve. Kjo ndryshoi, u bë e mundur në atë moment kur Jezusi ishte në malin e shenjtë. Ndoshta ju e dini ngjarjen. Jezusi qe mbi këtë mal me tre të tijtë, më të dashurit nxënës të quajtur Pjetër, Jakob dhe Gjon të cilët janë mishërim i besimit, dashurisë dhe shpresës. Papritur Krishti u idealizua. Zoti i dashur vendosi ta shndërojë për një moment kështu që nxënësit e tij të kishin mundësi ta shikonin me të vërtetë se si ishte Jezusi dhe jo një njeri i thjeshtë me mish e me gjak si të gjithë ne. Qe vetë perëndia në njeriun Jezus. Kjo qe kaq e mrekullueshme sa që Pjetri tha me entuziazëm: “Këtu le të ngremë ne kasollen tonë.” Kjo do të thotë se këtu duam të rrimë ne, sepse është shumë mirë këtu. Tani le të nxjerrim ne kuptimin e plotë. Papritur panë ata dy figura nga përjetësia. Moisiu dhe Elia erdhën dhe Jezusi foli me ta për zgjidhjen, planin që ai do të kishte për në tokë. Që nga ai moment e tutje mundën Moisiu dhe Elia pasi u kthyen përsëri në mbretërinë e të vdekurve, për tu treguar se Jezusi tani jetonte me trup në këtë tokë. Ai do të sillte atë sakrificë që do të jepte mundësinë e faljes së mëkateve dhe njeriu të kthehej në një krijesë të re. Për herë të parë bëhet e qartë fjala të cilën Davidi e ngrente si pyetje: “A do të bëje ti ende ndër të vdekurit mrekulli?” Përgjigja është e qartë: Po, ai do të bëjë. Në fillim iu desh Jezu Krishtit të japë sakrificën. Mbas kryqëzimit që e coi atë në vdekje, ai zbriti në mbretërinë e të vdekurve. Ne lexojmë se ai zbriti në vendin më të thellë të tokës. Kështu shkruan Pauli tek Efesianët dhe thotë: “A nuk ka vallë fuqi ai që poshtë, aq thellë zbriti, deri tek të vdekurit, për tu ngjitur përsëri lart?” Dhe pastaj erdhi edhe ngjitja e njohur në qiell e Jezusë, gjë qe nuk mund ta besojnë të gjithë. Ata thonë se kjo nuk është e mundur. Për këta e thotë Pauli tek Efesianët qartë e bukur: “Ai që forcë pati për të shkuar poshtë, mund të ngjitet edhe lart.” Pjetri shkruante në letrën e tij: “Prej atij që zbriti poshtë dhe që predikoi shpirtrave në burg, atyre që para dhe në kohën e Noas nuk mund të besonin.” Ja pra që është interesant, të dashur motra e vëllezër, Pauli e shkruan këtë



tek Efesianët, Pjetri në letrën e parë të tij. Me të drejtë na lind pyetja: “Si e dinin këtë Pauli dhe Pjetri? Ata nuk kishin qenë me të. Për këtë ka vetëm një përgjigje: Ose ja u ka bërë të qartë vetë “i ringjalluri” mbas ringjalljes ose shpirti i shenjtë donte t’ i tregonte qartë të gjithë apostujve të Jezusë të asaj kohe dhe të gjithë besimtarëve të tjerë që Jezu Krishti shkoi në mbreterinë e të vdekurve për të sjellë më pranë clirimin e shpirtrave. Nëse më parë Davidi pyeste: “A do të bësh ti mrekulli edhe tek të vdekurit?”, Jezusi mund t’ i përgjigjej se erdhi koha që edhe tek të vdekurit mund të ndodhnin mrekulli. Le të kujtojmë fjalët që Jezusi u tha nxënësve të tij kur ai ishte midis tyre. Një herë ai u tha: “Do të doja tu thosha shumë por e di që nuk mund t’ i mbani të gjitha tani” Po kush nga ne e di se c’ u tha Jezusi mbas ringjalljes së tij nxënësve të tij në ato 40 ditë që ndejti



me ta, para se të ngjitej në qiell? Prandaj edhe pyetjes se nga e dinin apostujt e atëhershëm se ndodhte edhe kështu, që edhe të vdekurit të ndihmoheshin, mund t’ i përgjigjeshim se Zotnia ua ka bërë cdo gjë të qartë dhe ata vepruan kështu. Ne mbahemi nga shumë besime apo kisha të tjera kristiane se bëjmë një padrejtësi kur ne shpërndajmë shenjtërimet e kishës së Jezusë edhe tek të vdekurit. Nga se e dinë atëherë Apostujt e kohës sonë se duhet të veprojnë kështu? Së pari se edhe apostujt e kishës mëmë kështu kanë vepruar dhe se shpirti i shenjtë ua ka bërë të qartë gjithcka. Prandaj veprojmë ne po kështu sot, të dashur shpirtra, dhe të gjithë ata që vdiqën pa u pagëzuar dhe që janë mëshiruar nga Zoti, mundet të vijë për pagëzim. Të gjithë ata që janë të përgatitur mund të marrin pjesë në darkën e shenjtë dhe tu falen mëkatet. Të gjithë ata që janë të përgatitur mund të marrin vulën e shenjtë nga vetë shpirti i Zotit. Dhe si përgjigje të pyetjes së psalmistit: “A do të bësh ti mrekulli edhe tek të vdekurit?” ne mund të themi sot: “Po, Zoti ynë i dashur bën mrekullira edhe tek të vdekurit.” Të gjithë ata që e pranojnë fjalën e Zotit si të vërtetë, si dëshmi. Të gjithë ata që ngrihen e zbresin tek altari dhe e pranojnë fjalën e Zotit me besim, ata që janë të pajtueshëm dhe që mund të falin, tek ata ndodhin mrekulli. Do të këputen zinxhirët që i mbanin të lidhur. Akuzat, mendimi i keq, do të pushojë së qenuri. Urrejtja që njeriu do të kishte në zemër do të largohet. Plagët që dikur digjnin do të kurohen. Këta shpirtra marrin veshje të re, mbështillen me petkun mbretëror e hyjnor. Pasi marrin shenjtërimet e kishës shkojnë në një banesë të re. Me të vërtetë ndodhin mrekulli tek të vdekurit. Le ta besojmë këtë dhe të jetojmë me këtë mendim. Të dashur motra e vëllezër ndodhin edhe tani. Përpara nuk kemi besuar ndoshta fare. Ishim ateistë. Gjithcka që kishte të bënte me Zotin, shpirtin dhe përjetësinë ishte e huaj për ne, ndoshta dhe qesharake. Apo dikush ka pasë besim tjetër e jo si ky që besojmë tani. Por ja që ne u zgjuam e

erdhëm para altarit të Perëndisë e pranuar ftesën e tij, pranuar fjalën e tij dhe i bëmë vend që të punojë e të rritet. Rritëm njohuritë, u bëmë të pajtueshëm, më të butë në zemër. Cfarë ka ndodhur me ne? U bëmë krijesa të reja, nga njerëz, në fëmijë zoti. Ata, që deri dje kanë mallkuar, sot luten. Le të ecim gjithnjë e më tutje në këtë besim dhe të shkelim nga një njohuri në tjetrën. Si t’ i quajmë të gjitha këto? Edhe këto janë mrekullitë e ditëve tona. Të dashur motra e vëllezër, njerëzit pyesin shpesh se c’ janë mrekullitë. Me këtë ata kuptojnë një i sëmure të shërohet, kur një i vdekur të ngjallet apo kur dicka mbinatyrore të ndodhë. Kjo do të quhej mrekulli. Kur ata këtë mrekulli ta jetonin, shikonin, atëherë do ta besonin. Porse kjo është rruga e gabuar. Jo ta përjetosh, shikosh, njëherë një mrekulli e pastaj ta besosh por në fillim të besojmë e pastaj të përjetojmë mrekullitë. Do të jetë për ne një mrekulli që do të mbesë, që ne kemi ndryshuar dhe jemi bërë njerëz të tjerë. Të dashur motra e vëllezër, unë dëshëroj që kjo ditë të jetë për punën e Zotit në Shqipëri një hap i madh përpara, të jetë që për të gjithë ata shpirtra që u ngjitën në përjetësi pa u pajtuar e pa i falur të tjerët, shpirtra që kanë vdekur shekuj më parë nga pushtimet e huaja, të kenë mundësi të pajtohen e të clirohen. Ndërsa për ju, të dashur motra e vëllezër, dëshëroj që nëpërmjet fjalës së Zotit dhe mëshirës së tij, të merrni forca të reja dhe pastaj me anë të besimit tonë të madh dhe nëpërmjet rrezatimit tonë, të mbledhim rreth vetes shpirtra të tjerë. Le ta themi më thjeshtë: Unë dëgjova se kjo sallë e bukur këtu në Tiranë ka më shumë se 2000 vende. Ndërsa sot ne jemi pak më shumë se 1000. Kur apostuli juaj i distriktit ndonjëherë tjetër të vijë e t’ ju mbledhë, le të jetë ky vend krejtësisht i mbushur. Edhe kjo do të jetë atëherë një mrekulli e Zotit. Ai bën mrekullira ndër të vdekurit e ndër të gjallët pasi dëshiron që t’ i ndihmojë të gjithë si ata të kësaj bote ashtu edhe ata të botës së përtejme. Kur ai të ketë ndihmuar të gjithë ata që ja pranojnë ndihmën, atëherë do të dërgojë ai birin e tij e do të përfundojë punën e nisur. Pastaj do të kemi arritur në qëllimin e besimit e do të shikojmë me sytë tanë atë që kemi besuar deri në atë kohë. Pikërisht për këtë ditë gëzohem unë që sot ashtu si një fëmijë i cili e di që në një festë të madhe do të marrë dhuratë. Cfarë është, pra, kjo dhuratë e madhe që në e presim? Një makinë e bukur, një shtëpi e re, gjithmonë shëndet, shumë lekë? Këto do të na gëzonin? Dhuratë më e madhe është kjo bashkësi e fëmijëve të Zotit. Të qëndrojmë besnikë deri në fund e të marrim pjesë në Ringjalljen e Parë se sic shkruhet edhe tek Apokalipsi: ...”I bekuar e i lumtur është ai që merr pjesë në Ringjalljen e Parë.” Le të na mbajë e të na ndihmojë Zoti me mëshirën e tij deri në këtë ditë!



Tani rreth meje janë edhe shoqëruesit e mi, apostuj nga vende të ndryshme të botës. Kështu nuk ka ndodhur ndonjëherë në Shqipëri. Dhe do gëzohesha nëse do tu prezantoja njerin apo tjetrin. Nga Amerika është një apostul këtu. Është apostuli i distriktit (ndihmës) Fendt nga Nju-Jorku. Kur ai të ngrihet këtu do të shërbejë në anglisht

dhe përkthyesja do të na i përkthejë direkt nga anglishtja në shqip. Korrit i lutem të këndojë një strofë.

Korri: “Kur je në paqë me Zotin ...” - shqip - (LK 443)

Apostuli i distriktit (ndihmës) Fendt: Të dashur motra e vëllezër të besimit. Për mua është me të vërtetë një përjetim i madh e i mrekullueshëm e jam i prekur thellë që ndodhem midis jush. Jam i gëzuar që jemi të gjithë me apostulin kryesor e që mu dha mundësia të takoj motrat e vëllezërit e mi shqiptarë. Unë kam patur mundësinë për të qenë fëmijë Zoti qysh nga lindja por kurrë nuk kisha ëndërruar se një ditë do t’ju takoja ju. E kur apostuli ynë kryesor në fjalën e sotme ngriti një pyetje: “A do të bësh ti mrekulli edhe tek të vdekurit?” ne mund të themi se prova që Zoti mund të bëjë mrekulli ndër të vdekurit është e qartë nga mrekullia që ai ka bërë pikërisht këtu ku është një pjesë e familjes së tij dhe me mëshirën e tij. Përpara se shërbesa të fillonte një grup nga fëmijët tuaj erdhën në dhomën e vëllezërve dhe na kënduan një këngë që e kemi mësuar që kur ishim fëmijë: “Zoti është vetë dashuria, ai na do ne të gjithëve” Të dashurit e mi, Fëmijët thanë të vërtetën. Zemrat e fëmijëve janë të pastra, nuk ndyhen nga papastërtitë që marrim ndërsa rritemi. Për fëmijët nuk ka rëndësi ngjyra e lëkurës, ata s’ e pyesin tjetrin se nga vjen e megjithëse nuk e kuptojnë gjuhën e njëri-tjetrit, ata mësohen e gëzohen me shoqërinë e njëri-tjetrit. Dhe kur ngatërrohen me njëri-tjetrin po kaq shpejt harrojnë e falin. Prandaj edhe Jezusi tha që ne duhet të jemi si fëmija. E shoh se sot nuk ka shumë fëmijë këtu por zemra që besojnë si fëmijë janë shumë e vetëm këto zemra mund të besojnë në mësimet e apostujve të Jezusë. Duke dëgjuar historinë tuaj dhe për herojtë e së kaluarës, cdo njeri duhet të vlerësojë faktin se falë tyre ne na është dhënë mundësia për të qenë këtu sot. Prandaj na bie detyrë që të



bëjmë dicka për ta. A është e mjaftueshme të ngresh për ta një statujë të bukur, apo të kesh një muzeum të bukur si ai që vizituam dje. Cila është gjëja më e madhe që mund të bëjmë për ta? T’u tregojmë se c’ mund të fitohet nga mëshira e Zotit. Që ne si një familje të mund të falim, të harrojmë, të jemi në pajtueshmëri me njëri-tjetrin e të pregatisim kushtet për ata që do të zbresin nga perjetësia. Pajtueshmëria dhe falja është pjesë e jetës sonë. Do të doja t’ju tregoja dicka që e kam jetuar vetë. Disa vite më parë ne ngritëm bashkësinë e parë kineze në Nju-Jork dhe një të dielë një vejtshë erdhi për herë të parë në shërbesë me djalin e vogël 6 vjecar. Burri dhe tre fëmijë u vranë ndërsa mundoheshin t’i shpëtonin persekutimit. Ajo kishte kërkuar gjithandej se ku mund të gjente ngushëllim. Ku mund të harronte urrejtjen dhe hakmarrjen ndaj

atyre që vranë familjen e saj. Një motër apostolike i tha: “Hajde njëherë në kishën tonë.” Ajo erdhi bashkë me djalin e saj të vogël një orë para se të fillonte shërbesa. Ishin gjithsej 50 veta. Ajo u ul, korri këndoi e ajo iu kthye djalit e i tha: “Unë nuk kuptoj se c’ thonë këtu.” Unë nuk di se c’ duhet të bëj për të qenë pjesëtare e kësaj bashkësie. Por është hera e parë qëkur babai, vellezërit e motra jote kanë vdekur që unë ndjej ngushëllim në shpirt, bile po e ndjej se mund të fal edhe ata që i vranë. Dhe kur shërbesa fetare përfundoi, ajo vetëm pyeti se c’ duhet të bënte për të qenë pjesëtare e kësaj kisha. Kjo del nga zemra e cdo fëmije Zoti kudo ku ata mblidhen. Sa bukur! Kur ne jemi sot një bashkësi e tillë, të gjithë paraardhësit tanë, heronjtë e së kaluarës thërriten sot para altarit me aq dashuri nga vetë Perëndia dhe të gjithë bashkë do të rrojmë në paqë e do të falim. Vetëm atëherë do t’u tregojmë atyre se ne i vlerësojmë e që ata mund të quhen pjesë e familjes sonë. AMEN

Apostuli kryesor: A nuk është bukur, të dashur motra e vëllezër? Përpara se të fillojë shërbesa vetëm nga atmosfera e shtëpisë së Zotit, nga kënga e korrit mbusheshin këta shpirtra me paqë e ngushëllim dhe fjala e Perëndisë i drejtonte nga lart. E përjetofshi edhe ju këtë gjë gjithmonë, ndonëse nuk keni akoma kishën tuaj, sa herë që mblidheni këtu apo aty para altarit të Zotit. Do të vijë dita të keni edhe kishat tuaja por e rëndësishme është se kudo ku mblidheni, ndjeftë shpirti juaj paqë e ngushëllim përpara se shërbesa të fillojë, që fjala e mëshira e Zotit t’ju drejtojë që nga lart.

Nga Austria është edhe Apostuli Kainz këtu. I lutem që edhe ai të shtojë dicka. Besoj që korri do të këndojë edhe një strofë. Korri këndon në shqip: “Atje lart ndodhet vendlindja ime.” (LK 633)



Apostuli Kainz: Të dashur motra e vëllezër. Një herë një besimtar i hodhi një vështrim së kaluarës së tij dhe arriti në konkluzion se vërtet jeta e tij kish pasë halle e probleme porse më e madhe se këto halle kishte qenë mëshira e perëndisë. Atëherë lind pyetja: “Nga se vjen kjo, si ndodh kështu?” Ka vetëm një përgjigje; “Zemërgjerësi është kjo dhe asgjë tjetër.” Të dashur motra e vëllezër si ndodhi që unë sot jam këtu? Përsëri mund të përgjigjem unë si burrë: “Ishte zemërgjerësia e apostulit kryesor që më ftoi. “Dhe nëse ju do të pyeteshit se përse jeni bërë apostolikë të rinj? Nga se erdhi kjo? Unë besoj se ju të gjithë mund të përgjigjeni: “Nga zemërgjerësia, mëshira dhe dashuria e Atit tonë qiellor.” Para tri vjetësh, kështu tha apostuli kryesor, nuk kishte as një apostolik në këtë vend. Por ja që erdhi koha dhe Jezu Krishti shkeli edhe në këtë vend e hodhi farën e tij dhe na u tha se mëshira e tij është mbi ne dhe sic tha dhe apostuli kryesor, kushdo që e merr këtë mëshirë do të jetë i lumtur.

Tani apostuli kryesor na e bëri shumë të qartë se mëshira nuk është e rëndësishme vetëm për ne që jetojmë këtu në tokë dhe se ati ynë qiellor dëshëron tua japë këtë mëshirë edhe shpirtrave që tashmë s' jetojnë. Sa njerëz kanë shkuar në përjetësi të mbushur me urrejtje, të tjerë që nuk e kanë kuptuar se c' është dashuria. A nuk ka edhe sot njerëz që nuk e kanë provuar se c' është dashuria? Nëse njerit prej jush do t' i thuhet: "Është njëri atje që të do", ai nuk do ta kuptonte se cdo të thotë "dashuri"



pasi nuk e ka provuar atë. Por pasi ai ta ndjejë ngrohtësinë atëherë do të hapi zemrën ai. Është kështu sikur dielli ndricon e ngroh gjithcka përreth. Po kështu është edhe me dashurinë e shpirtit. Dielli nuk ndricon vetëm këtë tokë, ai i lëshon rrezet deri në botën e përtejme. Po kështu edhe dashuria e Zotit nuk është vetëm për ne por arrin deri në mbretërinë e përtejme. Dhe kur atje shpirtra të shumë të dëgjojnë: "Ka mëshirë edhe për ty. Ti je një shpirt i dashur", ndoshta do të zgjasë pak, porse zemra do të hapet dhe ata do të

zbresin tek altari e ndoshta do të pyesin: "C' duhet të bëj unë që biri i Zotit ta kuptojë që unë dua shpëtim?"

Ndërsa apostuli kryesor shërbente, unë mendova për një të ri apostolik të shtruar në spital. Pranë kishte një të ri tjetër që qe shumë i sëmurë. Vëllai ynë i besimit, ky i ri apostolik foli shumë rreth besimit dhe një mbrëmje foli edhe për ardhjen e Jezusë. Pastaj i ri tjetër pyeti: "Mirë, po çfarë duhet të bëj unë që Biri i Perëndisë ta kuptojë se edhe unë dua të shkoj me të?" Vëllai ynë i besimit i tha: "Ti duhet vetëm të zgjasësh dorën e Lord Jezusi do ta shohë se ti dëshëron të shkosh me të." Një përgjigje e bukur prej fëmije. Erdhi dita tjetër, mjekët hynë në dhomë dhe iu afruan krevatit të djalit. Ata konkluduan se djali kish vdekur natën. Por ajo që u bëri më shumë përshtypje qe dicka që se kishin parë kurrë. Ky djalosh kishte vdekur me duar të shtrira. Përpara se të vdiste duhet t' i kishte ndodhur dicka në shpirt, dicka që e bëri të shtrinte duart. Nëse shpirtra nga përjetësia do të pyesnin: "Çfarë duhet të bëjmë ne për tu gëzuar?" Ne mund t' ju themi: "Zgiate dorën, kape atë të apostulit kryesor. Ai do të të cojë ty në duart e Jezusë, atëherë do të ndërrosh ti banesë, atëherë mund të këndosh etje ti, ashtu sic kënduan këngëtarët, - "Atje lart ndodhet vendlindja ime." AMEN

Apostuli kryesor: A e mbajmë ne dorën gjithnjë të shtrirë aq sa Perëndia të mund ta arrijë e të na drejtojë? Pastaj le të ndodhë çfarë të dojë, ne jemi të mbrojtur nga ai. Unë jam i bindur plotësisht se edhe nëse ai fëmijë për të cilin apostuli tregoi, nuk e kishte vulën e shenjtë, pra nuk ishte fëmije Zoti, ai është pranuar e mëshiruar nga vetë Lordi e do të jetë me të gjithë ata që nga atje lart do të zbresin sot për të marrë mëshirën e Perëndisë.

Edhe nga Rumania është një apostul këtu, apostul Cone. Por c' e do që ai flet rumanisht dhe asnjë nuk e kupton atë këtu. Prandaj do të komplikohet pak puna. Probleme ka, megjithëatë njeriu mund t' i zgjidhë ato. Apostul Kone do të shërbejë në rumanisht, apostul Kainz do ta përkthejë atë në gjermanisht dhe nga gjermanishtja në shqip do të na i përkthejë perkthyesja jonë. Një herë shërbeja në gjermanisht në Afrikë. Pranë meje qëndronte i pari (anglisht), pastaj një burrë tjetër (gjuhën bazë afrikane), i treti burrë (në një gjuhë tjetër afrikane) e deri sa më vinte radha përsëri mua, kisha mjaft kohë për të ndenjë ulur. Dhe çfarë ka përkthyer i treti, unë s' jam i sigurt a ka qenë identike me atë që unë thoja. Por më e bukura qe se në fund të gjithë thanë 'AMEN'. Le të veprojmë po kështu me apostul Kone dhe i lutem apostulit Kainz edhe një herë që të vijë këtu.

Apostul Cone: Shërbeu në rumanisht, apostul Kainz përktheu në gjermanisht: Të dashur motra e vëllezër. Jam thellësisht i prekur që ndodhem në krah të apostulit kryesor. Kështu i prek gjithnjë shpirti i shenjtë zemrat e fëmijëve të Zotit. Unë jam i bindur plotësisht se e njëjta gjë ndodh edhe me ju pasi shikoj sytë e zemrat tuaja. Fjala që dëgjuam direkt nga zemra e apostulit kryesor ka prekur të gjithë zemrat. Një pjesë e shpirtrave janë këtu, i shikojmë, porse pjesa më e madhe që është në përjetësi

e të cilën nuk mund ta shikojmë se si sot ata kanë ardhur tek ne. Edhe ata janë të prekur thellë. Nëse ne me të vërtetë do të mund të shikonim se çfarë ndodh në altar do të ishim prekur thellë. Fjala e fundit që apostuli ynë kryesor tha, ishte: "I bekuar e i lumtur është ai që merr pjesë në Ringjalljen e Parë " Të dashurit e mi, unë kam menduar se ne jemi thirrur këtu për të qenë të bekuar e të lumtur.



Shërbesat që Jezusi i ngriti, zëdhënësit që ai ka dërguar e dërgon, kanë ardhur për të na përgatitur për atë moment të madh të Ringjalljes së Parë. Ne mund të jemi përgjithmonë të lumtur në vendlindjen hyjnore. Më kujtohet një shembull dhe një ndodhi, që e kam dëgjuar nga një apostul. Sigurisht që si njerëz ne shpesh përjetojmë situata të tilla që na gëzojnë por ama edhe që na dëshpërojnë. Biem shpesh në situata të tilla kur kërkujmë ngushëllim e mundohemi që të gjejmë shkaktarin apo shkaktarun e kësaj mërzi të tyre. Arrijmë deri aty sa të kemi mendime të tilla që na cojnë deri në hakmarrje.

Por këtu, në shtëpinë e Zotit, nën mëshirën e tij ndërrojmë ne edhe mendimet. Kështu na e tha edhe apostuli kryesor se pak më parë ne kemi mallkuar kurse tani lutemi e dimë të falim. Unë thashë që do tu jap një shembull të cilin e kam dëgjuar nga një apostul. "Një motra jonë kishte bërë një jetë shumë të keqe me të shoqin. Ai shpesh e rrihte dhe e fyente. Pas disa kohësh i shoqi i vdiq e kjo motër u bë femijë Zoti-po e përsëris edhe një herë-u bë femijë Zoti porse kishte një problem të madh. Ngaqë kishte vuajtur shumë ajo nuk mund t' a falte kurrë burrin. Këtë ia kishte thënë edhe priftit të vet. E ai i ishte përgjigjur: "Motër e dashur nëse do që Zoti të të falë, duhet që edhe ti të falësh. Ne nuk e dimë me siguri por në shpirtin e kësaj motre pa tjetër që një luftë e madhe është bërë dhe kur prifti e pyeti: "Si jeni?" ajo iu përgjigj: "Prifti im i dashur, jam përpjekur ta fal burrin tim e të harroj të gjitha ato vuajtje e mjerime që kalova e që ai mi shkaktoi dhe e kam falur". Ditën tjetër ajo vdiq. Sot kemi ne mundësinë për të ndryshuar atë që duhet të ndryshojmë, mund të falim ato që ndoshta deri më sot nuk kemi mundur t' i falim. Në zemrën tonë duhet të zenë vend fjalët që apostuli kryesor tha: "I bekuar e i lumtur është ai që merr pjesë në Ringjalljen e Parë." AMEN

Apostuli kryesor: Është një fjalë paralajmëruese kjo, të dashurit e mi. Sot ne jemi këtu. Për nesër thurim ne plane të ndryshme. Unë kam planifikuar që nesër të kthehem në shtëpi, pasi atje shumë punë më pret dhe shërbesa tjetër vjen shpejt. Me siguri që edhe ju thurni planet tuaja por mund të ndodhë krejtësisht ndryshe nesër, si asaj motre që sapo dëgjuam: Të nesërmen ajo vdiq. Kush e din nga ne se cdo të sjellë e nesërmja? Po qëndruam në duart e Zotit, le të ndodhë çfarë të dojë, ne do të jemi të mbrojtur nga ai. Prandaj ju bëj thirrje ju, shpirtra të dashur, ne duhet të mbetemi besnikë dhe pasues sepse gjithëka tjetër nuk do të shpërblehet. Ndërsa ai që e jetoi jetën mirë, që mori dhe e pranoi fjalën e mëshirën e Zotit dhe ai që pati fatin që shpirti i tij të ishte i zgjedhur, ai do të mbetet në bashkësinë e shërbëtorëve dhe fëmijëve të Zotit.

Dhe tani kemi mundësinë të marrim të gjithë bashkë darkën e Zotit dhe këtë ne e bëjmë me një dëshirë të madhe e me gëzim në zemër. Prandaj le të ngrihemi e të bëjmë lutjen "Ati ynë."

Mbas "Ati ynë" vazhdon

Lutja: Ne të falenderojmë, i dashur at, për fjalën tënde. Është dritë dhe jetë. Le ta ruajmë fjalën tënde në zemër pasi ajo na jep forcë, fuqi. Është një mbështetje, bastun në dorën tonë. Ne e falenderojmë edhe për mëshirën që tregoi në faljen e mëkateve. Gjithcka, vërtet gjithcka, që ne kemi bërë gabim është larë në gjakun e Jezusë. Dhe asnjë shpirt s' ka më forcë mbi ne. Sa mëshirë e madhe është kjo! Bëj që të gjithë motrat e vëllezërit tanë këtu të të ndjekin me besnikëri më tutje dhe të provuarve jepu mundësinë të të njohin ty në ardhjen tënde. Nxite punën tënde në këtë vend. Bekoje këtë popull, këtë vend e këtë qeveri e jepi gjithnjë paqe kësaj toke. Nën bekimet e tua le të rriten të gjithë. Dhe tani vendos bekimet e tua edhe mbi sakrificën e këtyre shpirtrave, beko duart dhe zemrat që sakrifikan dhe le ta ndiejnë të tutë se çfarë ty të jepet në këtë tokë nuk i varfëron këta shpirtra pasi ata janë nën bekimet e tua. Dhe tani ne mezi presim të marrim darkën e shenjtë të cilën po e shenjtëroj dhe e bëj të vlefshme

për darkën e Zotit duke i shtuar asaj sakrificën e Jezusë të dhënë një herë por që është e vlefshme përgjithmonë me fjalët e Lordit: Hajdeni të hani, është trupi im që u flijua për ju, hajdeni të pini, gjaku im u derdh për të falë mëkatet e juaja. Sa herë që ju ta merrni këtë, hajeni në kujtimin tim. AMEN

Apostuli kryesor: Kështu pra, motra e vëllezër të dashur, ne mundëm të marrim të gjithë darkën e shenjtë dhe tani vjen momenti më i madh ku unë do të bëj shenjtërimet e kishës për të gjithë shpirtrat e vdekur, pra pagëzimin me ujë, shpirtin e shenjtë dhe darkën e shenjtë. Këtë unë e jap nëpërmjet dy apostujve tanë, që jetojnë dhe këta si mbartësa mund tua shpërndajnë të gjithë atyre shpirtrave të vdekur që dëshërojnë t' i marrin. Se sa janë ata që do ta marrin këtë, unë nuk e di. Ne do ta shikojmë kur tia kemi arritur qëllimit. Si është e mundur që nëpërmjet një hostje që unë vendos në dorën e një apostuli, një mijë të tjerë të mund ta marrin? Do të doja t' ja u sqaroja me shëmbullin e radios. Është studioja e shpërndarjes prej ku jepet fjala e muzika, dhe në të gjithë vendin dhe nëpër shtëpia ka aparate për të dëgjuar se çfarë jepet. Njeriu duhet të gjejë thjesht frekuencën e pastaj s' ka rëndësi nëse një qind apo dhjetë mijë janë ata që e dëgjojnë. Pra nga



një vend shpërndarjeje, të gjithë ata që kanë gjetur frekuencën e duhur, marrin gjithcka që dërgohet nga studioja. Po kështu ndodh edhe me sakramentet. Kur shpirtrat e tyre të jenë të përgatitur, marrin ata nëpërmjet dërguesve të Zotit në tokë, gjithcka që është përgatitur për ta, s' ka rëndësi nëse janë një qind apo qindra mijë. Le të ngrihemi atëherë dhe i lutem të dy apostujve König e Klippert të vijnë tek unë.